



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 497 Prot

Datë 01/03/2019

VENDIM

Nr. 94 , Datë 01.03. 2019

PËR

**“MIRATIMIN E RITJES SË TARIFËS PËR PROVIMIN E GJUHËS SË HUAJ NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar me Urdhërin e MASR Nr. 816 datë 26.12.2018, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” , Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Nr. 1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, deri në miratimin e buxhetit të konsoliduar për vitin 2019, sipas kërkesës së Administratorit të UT-së Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Të miratojë rritjen e tarifës për provimin e gjuhës së huaj nga 3.000 lekë në 6.000 lekë.
2. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, si dhe përfshirjen e tij në buxhetin konsoliduar të vitit 2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi me dt 01.09.2019.

